

**FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS SË OSBE-së, AMBASADORIT WOLLFARTH**  
**"Takim i Përvitshëm për Parandalimin dhe Luftën**  
**kundër Kultivimit të Bimëve Narkotike"**

*13 prill 2012*

Ministri Nishani,  
Kryetarë bashkish e komunash,  
Drejtori i Përgjithshëm Burgaj,  
Zonja dhe zotërinj,

Tema e sotme "Takim i Përvitshëm për Parandalimin dhe Luftën kundër Kultivimit të Bimëve Narkotike" tregon qartë se trajtohet një detyrë e madhe dhe prania juaj personale këtu tregon se kjo punë merret me shumë seriozitet.

Së pari, do të doja t'ju falënderoja juve, Ministri Nishani, për drejtimin e kësaj lufte kundër narkotikëve dhe për nismën tuaj për këtë takim të rëndësishëm sot. Më lejoni t'ju siguroj, z. Ministër, se ju personalisht dhe gjithë ekipi juaj mund të keni besim te mbështetja jonë e vazhdueshme dhe t'ju falenderoj për fjalët e mira që thatë në fjalimin tuaj për Prezencën e OSBE-së.

Për Prezencën e OSBE-së në Shqipëri, rëndësia e madhe e këtij aktiviteti ka dy arsye.

E para lidhet me qëllimin e takimit, i cili synon të zvogëlojë dhe, mundësisht t'i japë fund, prodhimit të paligjshëm të bimëve narkotike në Shqipëri.

Arsyeja e dytë lidhet me mjetet dhe mënyrat se si arrihet ky qëllim.

Eliminimi i çdo kultivimi të bimëve narkotike në territorin shqiptar është një çështje me interes kombëtar. Prodhimi dhe konsumimi i narkotikëve të paligjshëm sfidojnë shtetin e së drejtës, ekonominë dhe shëndetin publik, siç do të bënin në çdo vend tjetër.

Krimi i kultivimit të përgjithshëm nuk është i vetëm, me të vijnë edhe shumë krime të tjera.

Drogat e paligjshme, të çfarëdolloj forme, përbëjnë kudo një plagë dhe lufta kundër kultivimit të bimëve narkotike ka qenë me të drejtë një nga përparësitë kryesore të qeverisë shqiptare dhe Policisë së Shtetit gjatë mbajtjes së takimeve të këtij lloji që prej vitit 2002.

Autoritetet shqiptare bëjnë shumë mirë që e trajtojnë këtë çështje shumë seriozisht dhe shumë profesionalisht.

Ne e shohim Policinë e Shtetit shqiptar shumë të angazhuar në këtë luftë. Ndonëse janë bërë përmirësime të ndjeshme, të tjera sfida shtrihen përpara, probleme të rëndësishme ende presin zgjidhje.

Lejomëni të përmend si shembull çështjen e hershme të kultivimit të drogës në disa komuna në jug e në veri.

Kjo tregon qartë se Policia e Shtetit nuk mund të bëjë gjithçka e vetme për ta zhdukur këtë problem.

Mbështetja dhe bashkëpunimi i qeverive vendore është i domosdoshëm dhe vendimtar për gjithë procesin.

Shpeshherë mendohet se lufta kundër kultivimit të drogës dhe krimit në përgjithësi është një punë që i takon vetëm policisë.

Megjithatë, realiteti është ndryshe.

Realiteti na mëson se në një shoqëri demokratike, policia nuk mund të arrijë asgjë pa mbështetjen dhe bashkëpunimin e komunitetit.

Kjo është edhe arsyeja pse ne do të dëshironim të shihnim aktorët vendorë të motivuar dhe të përfshirë në mënyrë konstruktive në këtë çështje, shpresojmë kudo.

Bashkitë dhe komunat kanë detyrimin ligjor, moral dhe qytetar të bashkohen me Policinë e Shtetit shqiptar në detyrën e saj për të luftuar kultivimin dhe trafikimin e drogës.

Për çfarëdolloj krimi, parandalimi dhe frenimi janë më mirë sesa ndjekja dhe dënimi.

Edhe një herë, kjo mënyrë të vepruari është e hapur vetëm përmes bashkëpunimit midis gjithë aktorëve kryesorë.

Ministër Nishani,  
Kryetarë dhe miq,

Do të doja ta mbyllja duke thënë se, bazuar në mandatin tonë, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri mbetet shumë e gatshme t'i ofrojë asistencë dhe mbështetje të mëtejshme Policisë së Shtetit shqiptar dhe njësisë të qeverisë vendore për të nxitur dhe forcuar luftën kundër kultivimit të paligjshëm të drogave dhe për të ndihmuar duke inkurajuar zhvillimin e strategjive të duhura. Ne e bëjmë këtë së bashku me PAMECA-n dhe ICITAP-in.

Të luftuarit e kësaj plage është një qëllim i detyrueshëm, sjellja së bashku e policisë dhe komunitetit përmes një bashkëpunimi ekifas dhe eficient është rruga e duhur.

Dhe në fund, më lejoni t'ju shpreh të gjithëve urimet më të mira për sukses për këtë çështje sfiduese, në këtë luftë kundër krimit.

Arritjet tuaja do të ndihmojnë për të shtruar rrugën drejt një Shqipërie më të qetë e më të sigurt!

Ju faleminderit shumë!

**Fund**